

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, më Gjyqtaren Ilirjana Hoti dhe sekretaren juridike Flutur Nagavci, në lëndën penale kundër të akuzuarit F.G. nga fsh. L.,nga K-Gj. , për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/6-1 të KPRK-ës, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore-DP në Gjakovë, PP.II.12/18 të datës 23.02.2018, duke vendosur në lidhje me propozimin e PTHDP-Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me **dt.13.04.2018**, murr ketë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e PTH-DP ne Gjakovë PP.II.12/18 e datës 23.02.2018 dhe kjo Gjykatë, jep këtë :

URDHËR NDËSHKIMOR

I akuzuari:

F. GJ. , i lindur më dt.... në fsh. L. K Gj. , ku edhe tani jeton, i biri i D. dhe i nënës N. e gjinisë F. , i martuar , ka të kryer shkollën fillore, bujk, i gjendjes së mesme ekonomike , shqiptar , shtetas i R. Kosovës , me IDnr. tel.044-.....

Ë s h t ë f a j t o r

Se pse :

-me dt. 01.12.2017, rreth orës 12:00 ,në rrugë të fshatit B. – C. , Komuna Gj. , i pandehuri rrezikon trafikun publik duke shkelur nenin 53 lidhur me nenin 255 të Ligjit mbi rregullat e trafikut rrugor ,duke vënë në rrezik jetën e njerëzve dhe pasurinë , nga pakujdesia edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të ndodhë si pasojë e veprimit apo mosveprimit te tij , por me mendjelehtësi mendon se ajo nuk do të shkaktohet apo se ai mund ta ndaloj shkaktimin e saj dhe pasoja është shkaktuar , në atë mënyrë qe duke drejtuar automjetin e markës “O.A. ”, me targa të regjistrimit ... , me ngjyrë të gjelbër, duke mos e përshtatë shpejtësinë lëvizjes dhe kushteve atmosferike të rrugës , pasi që koha ishte me reshje shiu , në zonë vendbanimi , ashtu që e godet këmbësorin -të dëmtuarin (fëmijën) E. A. ,me pjesën frontale të automjetit , i cili ishte duke kaluar nga ana e majte në anën e djathtë të rrugës , me ç’ rast i shkakton lëndime të lehta trupore me dëmtim te përkohshëm, te shëndetit , lëndime te konstatuara dhe të përshkruar hollësisht në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr.F.B. të dt. 15.01.2018.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/6-1 të KPRK-ës

Andaj ,Gjykata komfor nenit 4,41,43,46,73, 378/6-1të KPRK-ës dhe nenit 495 te KPPK-se, të akuzuarin F. Gj. e,

G J Y K O N

Me dënimin me gjobë në shumë prej **300,00.-€ (treqind euro)**, të cilën shumë është i obliguar që ta paguaj në afat prej **15 ditësh**, pas plotfuqishmërisë, së këtij Aktgjykimi -Urdhri ndëshkimor, në kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

Nëse, dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma të tjera të parapara sipas nenit 46 të KPK-së, atëherë i njëjti dënim në bazë të nenit 46 par.4 të KPPK-së , i zëvendësohet me dënim

burgimi në kohëzgjatje prej **15 (pesëmbëdhjetë)ditësh**, duke llogaritur për çdo ditë burgu nga **20.-€ (njëzet euro)**.

Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

I akuzuari obligohet që të paguaj shpenzimet procedurale në shumë prej **61,00. -€**, (në emër të ekspertizës së komunikacionit dhe ekspertizës mjeko-ligjore) si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumë prej **30,00.-€**, e këtë në afat prej **15 ditësh** pasi që Aktgjykimi-Urdhri ndëshkimor të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Pranë kësaj Gjykate Prokuroria Themelore- Departamenti i Përgjithshëm në Gjakovë, ka ngrit Aktakuzën PP.II. 12/18 e datës 23.02.2018, ndaj të F.Gj. nga Gj. ,për shkak të veprës penale të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/6-1 të KPRK-ës.

Komfor nenit 493 te KPPK-së , PTH në Gjakovë , kësaj Gjykate i ka propozuar që ndaj të akuzuarit të lartcekur, pa mbajtur shqyrtimin gjyqësorë, të nxjerr urdher ndëshkimor dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënim me gjobë.

Para se të vazhdohet me arsyetim të Aktgjykimit për palët e pa udhëzuara është e nevojshme që t'i referohet dispozitës se nenit 378 par. 1 të KPRK-së, e cila dispozitë për kryesit e kësaj veprë penale parasheh dënim me gjobë ose me burgim gjerë ne 3 (tre) vite .

Gjykata me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes komfor nenit 495 te KPPK-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga dispozita e nenit 493 të KPPK-se dhe pa mbajtur shqyrtimin gjyqësor, vendosi që të pranoi kërkesën e PTH –se në Gjakovë, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe të shqiptoj ndaj të akuzuarit dënim me gjobë si në dispozitiv të Aktgjykimit .

Gjykata vlerëson se provat që i janë bashkangjitur propozimit për dhënien e urdhrin ndëshkimor të cilat gjinden në shkresat e lëndës siç janë:

- Kallëzimi Penal i lëshuar nr.ER-3004-455-2017 dt. 01.02.2017,
- Raporti i fillestar i oficerit i dt.01.02.2017.
- intervista e te dyshuarit me dt. 01.12.2017.
- deklarata e të dëmtuarit - i mituri E.A. me nr.rast:ER-3004-455-017.
- Ekspertiza mjeko –ligjore e Dr. F. B. dt.15.01.2018.
- Ekspertiza e komunikacionit e M.eng.L.S. e dt.10.02.2018
- Skicë e lirë e aksidentit .ER-3004-455-2017 dt.01.02.2017.
- Foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë.

Shkresat e lëndës janë prova të mjaftueshme me të cilat argumentohet se i akuzuari është kryes të veprës penale për të cilën akuzohet.

Gjykata këtë dënim e ka shqiptuar me bindje se me të njëjtit do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë në nenin 41 te KPRK-së në mënyrë që të parandaloi kryesin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe të përmbaj perso nat tjerë nga kryerja e veprave penale.

Vendimi mbi udhëzimin e palëve të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale edhe shpenzimet e paushallit gjyqësor është marrë në kuptim të nenit 450 par.1 dhe par.2 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi mbi urdhrin ndëshkimor.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
P.nr.172/18 te dt. 13.04.2018

Sekretarja juridike:
Flutur Nagavci

Gjyqtarja
Ilirjana Hoti

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është i lejuar kundërshtimi në afat prej **8 ditësh**, nga dita e marrjes së të njëjtës ,Gjyqtares të kësaj Gjykate .Nëse e pandehuri nuk ushtron kundërshtim, Aktgjykimi do të merr formë të prerë.